

B e n k e e S h q i p ë r i s ë

MATERIAL DISKUTIMI

I (17) 06

PARASHIKIMI I BILANCIT TË PAGESAVE

Diana Shtylla
Elvira Sojli



PËRMBAJTJA

1. Hyrje	6
2. Forma e bilancit të pagesave dhe lidhjet midis llogarive të tij	9
3. Metodologjia	11
I – Llogaria korente	11
II – Transfertat kapitale	13
III – Llogaria financiare	13
IV – Mjetet e rezervës	13
4. Të dhënat	14
4.1 Zërat e llogarisë kapitale dhe financiare, burimet e të dhënave dhe mangësitë në statistika	15
4.2 Mjetet e rezervës	18
5. Rezultatet	20
I – Llogaria korente	20
II – Llogaria financiare dhe kapitale	24
6. Parashikimi	26
I – Llogaria korente	26
II – Llogaria financiare dhe kapitale	27
7. Përfundime	29
8. Bibliografia	30
9. shtojcë - Tabelat e prezantimit të ekuacioneve	31
I - Llogaria korente	31
II - Llogaria kapitale dhe financiare	33
Shënime	35

ABSTRAKT

Në mënyrë që një shtet të mundet të mbulojë ripagimin e borxhit të jashtëm, janë të nevojshme suficite në bilancin e pagesave. Ky studim përqendrohet në ndërtimin e modeleve ekonometrike strukturore dhe jostrukturore, për të gjithë zërat e bilancit të pagesave. Nga projeksionet e kryera rezulton se fluksi i deritanishëm i financimeve të deficitit korrent mund të jetë i pamjaftueshëm për ta mbuluar këtë deficit dhe nevojiten prurje më të mëdha kapitale dhe financiare.

1. HYRJE

Shqipëria, që prej vitit 1996 ka regjistruar deficit korent në bilancin e saj të pagesave. Deficiti korent është luhatur midis kufijve -2 dhe -9 për qind të PBB-së.¹ Tregtia në mallra ka qenë elementi më përcaktues i ecurisë së llogarisë korente në këtë periudhë. Deficiti në tregtinë e mallrave është luhatur në kufijtë -13.7 dhe -24.1 të PBB-së. Ky deficit është balancuar pjesërisht nga suficitet e herëpashershme në kategorinë e shërbimeve dhe nga suficitet e vazhdueshme në kategoritë e të ardhurave dhe të transfertave korente. Financimi i deficiteve korente në vite, është mundësuar nëpërmjet hyrjeve kapitale në formën e kredive dhe investimeve të huaja.

Ndërkohë që investimet direkte janë vlerësuar si zhvillime pozitive në bilancin tonë të pagesave, huamarrja nga jashtë është dhe duhet trajtuar si një fluks që nga viti në vit, rrit stokun e detyrimeve të vendit ndaj huadhënësve. Edhe pse stoku i borxhit të jashtëm të Shqipërisë është mjaft i ulët në raport me PBB-në dhe po ashtu relativisht i ulët në krahasim me borxhin e jashtëm të shteteve të tjera në tranzicion, ky borxh imponon mbi vendin detyrimin për të gjeneruar në të ardhmen suficite të llogarisë korente. Vlera e tashme e pagesave të ardhshme të borxhit (amortizim principal dhe shlyerje interesash) duhet të jetë e barabartë me vlerën e tashme të të ardhurave të ardhshme nga eksportet e mallrave dhe shërbimeve.

Me fjalë të tjera, në mënyrë që një shtet të gëzojë aftësi paguese ose të jetë solvent, duhet që vlera e tashme e suficiteve të ardhshme të bilancit të vet korent, të jetë të paktën e barabartë me stokun e borxhit të vet të jashtëm.

Si rregull, parashikimi i bilancit të pagesave duhet të bëhet në përputhje me llogaritë e tjera makroekonomike, duke marrë parasysh nivelet e projektuara të aktivitetit ekonomik të vendit dhe të inflacionit, si edhe madhësinë dhe llojet e financimit të brendshëm dhe të jashtëm për të cilin ka nevojë qeveria, kompanitë shtetërore dhe sektori privat. Në të njëjtën kohë projektimet e bilancit të pagesave duhet të kënaqin identitetin e kontabilitetit

kombëtar, i cili kërkon që shuma e të gjitha transaksioneve korente të jetë e barabartë me shumën e transaksioneve financiare. Nga projeksionet e kryera në kuadër të këtij studimi, rezulton se financimi i deficitit korent në periudhat afatshkurtër dhe afatmesme do të kërkojë hyrje neto kapitale dhe financiare më të mëdha sesa hyrjet e parashikuara më vete në bazë të modelit. Diferenca midis hyrjeve kapitale që nevojiten dhe atyre që parashikohen është në varësi të skenarit të zgjedhur për parashikim, megjithatë, për secilin rast, kjo diferencë është e pranishme dhe e konsiderueshme.

Me fjalë të tjera, Shqipëria në periudhën afatshkurtër mund të përballet me probleme të financimit të deficitit të saj korent, nëse ajo nuk krijon mundësi për ngushtimin e deficitit korent ose për thithjen e kapitaleve me ritme më të larta se ato të regjistruara vitet e fundit.

Parapërgatitja për këtë studim ka nisur me një përpjekje tjetër të Bankës së Shqipërisë për parashikimin e tregtisë së jashtme.² Parashikimi i bilancit të pagesave përfaqëson një shtrirje të analizës përtej bilancit tregtar të vendit. Ky studim, nuk synon të vlerësojë qëndrueshmërinë e llogarisë korente të Shqipërisë apo të harmonizojnë parashikimet për sektorët e tjerë të ekonomisë me ato të bilancit të pagesave. Ai duhet konsideruar si një përpjekje për të identifikuar disa faktorë përcaktues të ecurisë së bilancit të pagesave të Shqipërisë, nëpërmjet metodave ekonometrike. Nëpërmjet identifikimit të këtyre faktorëve, gjetjes së koeficientëve dhe vonesave në kohë me të cilët ata veprojnë mbi zërat e bilancit të pagesave, si edhe nëpërmjet përcaktimit të dobësive më të dukshme të serive të statistikave, ky studim mund të përfaqësojë një bazë për përpjekje më të zgjeruara në të ardhmen.

Analiza është përqendruar kryesisht në vlerësimin e ecurisë së llogarisë korente, deficiti i së cilës ka kushtëzuar thithjen e kapitaleve në llogarinë kapitale dhe financiare. Në mungesë të të dhënave të sakta mbi kursimet dhe investimet në vend, bilanci korent është trajtuar si një rezultat i bilanceve të llogarive përbërëse dhe jo si diferencë midis kursimeve dhe investimeve kombëtare. Ky disagregim ka lënë hapësirë për vlerësimin individual të

serive përbërëse të llogarisë korente si: tregtia në mallra, tregtia në shërbime, të ardhurat dhe transfertat korente. Për shkak të vështirësive në mbledhjen e të dhënave, ekuacionet e paraqitura në studim janë forma të përshtatura të modeleve të propozuara nga literatura botërore mbi vlerësimin e kërkesës dhe ofertës për import/eksportet në mallra apo në shërbime. Në këtë studim, janë bërë përpjekje për të sqaruar:

- faktorët (variablat shpjegues) që kanë përcaktuar përgjatë viteve sjelljen e zërave (variablate të shpjeguar) përbërës të bilancit të pagesave;
- efektin e ose madhësinë e ndikimit të secilit prej këtyre variablate mbi variablat e shpjeguar;
- sezonalitetin dhe trendin e variablate të shpjeguar;
- ndikimin e periudhave shock;
- parashikimin për ecurinë e zërave të bilancit të pagesave në një periudhë afatshkurtër.

Duhet theksuar se për një pjesë të mirë të variablate dhe sidomos për ata të llogarisë kapitale dhe financiare, përfshirja e variablate ekzogjenë është tepër e vështirë. Kjo për shkak se, flukset hyrëse apo dalëse të kapitalit, më tepër se nga situata ekonomike, diferencat midis normave të interesit, stabiliteti ekonomik dhe politik, janë ndikuar nga faktorë të jo gjithnjë të parashikueshëm si privatizimi (investimet direkte hyrëse), mosvënia në përdorim e burimeve financiare për investime brenda vendit (dalja e depozitave jashtë), marrëveshjet dy dhe shumëpalëshe të borxhit (për huamarrjen nga jashtë), të cilat jo patjetër ndjekin një trend të caktuar etj..

Në këtë pikë, duhet theksuar edhe njëherë që forma për një pjesë të ekuacioneve është kushtëzuar nga problemet dhe mangësitë e të dhënave të gatshme (statistikat e bilancit të pagesave, PBB-së etj.) si edhe të atyre të ndërtuara si kursi real efektiv i këmbimit (REER), vëllimet e tregtisë së jashtme, çmimet relative etj.. Përmirësimet e ardhshme në drejtim të statistikave dhe të informacionit të disponueshëm, detyrimisht do të sjellin përmirësim të këtij modeli në drejtim të shpjegimit dhe të parashikimit të ecurisë së bilancit të pagesave.

Ky studim është i organizuar në këtë mënyrë: në seksionin pasardhës prezantohen elementet përbërëse të bilancit të pagesave. Në seksionin e tretë shtjellohet metodologjia e modelimit dhe në seksionin e katërt paraqiten karakteristikat e të dhënave dhe të gjitha mangësitë e lidhura me to. Rezultatet e modelimit paraqiten në seksionin pesë dhe parashikimi në seksionin gjashtë. Seksioni shtatë shtjellon përfundimet e studimit.

2. FORMA E BILANCIT TË PAGESAVE DHE LIDHJET MIDIS LLOGARIVE TË TIJ

Bilanci i pagesave, duke qenë statistika që mbulon marrëdhëniet e një ekonomie me botën e jashtme, merr një rëndësi të veçantë në kuadrin e analizave dhe të parashikimeve makroekonomike. Të dhënat e bilancit të pagesave janë të rëndësishme për monitorimin e zhvillimeve monetare dhe financiare si edhe për vlerësimin e politikave të vendit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Një pasqyrë e plotë e bilancit të pagesave lehtëson analizën makroekonomike në aspektet e mëposhtme të ekonomisë:

- ecurinë e të ardhurave;
- orientimin ndaj botës së jashtme;
- lidhjen midis tregtisë në mallra dhe shërbime dhe flukseve të investimeve direkte;
- transaksionet bankare ndërkombëtare;
- zhvillimet në tregjet financiare;
- situatën e borxhit të jashtëm të vendit.

Zhvillimet në bilancin e pagesave janë të lidhura në mënyrë të ndërsjellë me zhvillimet në kursin e këmbimit. Lëvizjet në kursin e këmbimit kanë një efekt direkt në ecurinë e tregtisë së jashtme dhe të investimeve të një ekonomie dhe rrjedhimisht edhe në pozicionin e bilancit të pagesave të kësaj ekonomie. Nga ana tjetër, pozicioni i përgjithshëm i bilancit të pagesave ushtron ndikimin e tij mbi kursin e këmbimit dhe mbi variabla të tjerë makroekonomikë.

Bilanci i pagesave paraqet transaksione reale dhe financiare, transferta të njëanshme si edhe ecurinë e mjeteve të rezervës së një vendi. Në pasqyrën e bilancit të pagesave, transaksionet grupohen në tre llogari të mëdha që janë³: llogaria korente, llogaria kapitale dhe financiare dhe llogaria e rezervave. Llogaria korente përfshin transaksionet në mallra, shërbime, të ardhura dhe transferta korente. Kjo llogari paraqet transaksionet ekonomike të një vendi me botën. Llogaria kapitale dhe financiare paraqet transaksionet në kapitale (mjete jo të prodhuara, jofinanciare) dhe ato në mjete financiare, që mund të jenë investime direkte, investime portofoli dhe investime të tjera. Mjetet e rezervës paraqesin lëvizjet në rezervat valutore të autoritetit monetar për periudhën për të cilën është hartuar bilanci.

Në parim, llogaria korente si dhe llogaria kapitale dhe financiare duhet të balancojnë njëra-tjetrën dhe bilanci i përgjithshëm i llogarive ose i pagesave, duhet të jetë zero. Në qoftë se vendi blen më shumë mallra dhe shërbime nga ç'i shet botës (pra nëse vendi regjistron deficite korente, gjë që është e vërtetë në rastin e Shqipërisë), ai është i detyruar të shesë mjetet e veta financiare për të financuar shpenzimet, (pra të regjistrojë një suficit në llogarinë e vet kapitale) ose të marrë borxh.

Deficitet ose suficitet në llogarinë korente, e cila, shpesh, përcakton sjelljen e të gjithë bilancit të pagesave, mund të jenë ose jo problematike, në varësi të rrethanave specifike të vendit. Për shembull, një vend që për një periudhë të kufizuar kohe regjistron deficit në llogarinë e tij korente si pasojë e zhvillimit të shpejtë të ekonomisë, nuk duhet të ketë probleme në financimin e këtij deficiti nëpërmjet hyrjeve të kapitalit në formën e investimeve direkte apo në forma të tjera. Nga ana tjetër, një deficit korent i vazhduar për disa vjet më radhë duhet të trajtohet me kujdes nga ana e politikëbërësve. Ekzistenca dhe vazhdueshmëria e deficitit korent bën të vështirë ose krejt të pamundur shlyerjen e detyrimeve të borxhit ekzistues, si edhe përkeqëson pozitat e vendit si huamarrës në arenën ndërkombëtare.

Qëllimi final i këtij studimi dhe i çdo analize afatgjatë të bilancit të pagesave, është vlerësimi i nevojës së vendit për financim të jashtëm,

si edhe i mundësive të tij për të shlyer detyrimet duke përdorur të ardhurat, që ai gjeneron nga aktiviteti i tij ndërkombëtar.

3. METODOLOGJIA

Për arsye se të dhënat për elemente të ndryshme të bilancit të pagesave sigurohen duke përdorur burime të ndryshme, vrojtime dhe vlerësime të sugjeruara nga metodologjia e bilancit të pagesave, edhe mënyrat e modelimit dhe të parashikimit do të jenë të ndryshme. Për këtë arsye, ato i kemi paraqitur të grupuara sipas ndarjeve në bilancin e pagesave.

I – LLOGARIA KORENTE

Bilanci tregtar – Shqipëria i plotëson të gjitha kushtet e supozimit të një ekonomie të vogël, sepse kërkesa e krijuar nga kërkesa jonë për importe është relativisht e vogël në krahasim me kërkesën vendase të vendeve partnere në tregti. Si rrjedhim, ajo nuk çon në ndryshim të çmimit të importeve dhe vendi përkufizohet si çmimmarrës për importet të shprehura në monedhë të huaj. Duke pasur parasysh se sasia e mallrave që ne eksportojmë është relativisht e vogël, atëherë ajo nuk duhet të ketë ndikim në çmimin e këtyre mallrave në tregun e vendeve partnere.

Për këtë arsye, edhe në kahun e eksporteve Shqipëria mund të konsiderohet si një vend çmimmarrës. Ky konstatim na lejon që të aplikojmë modelet e tregtisë që kanë si supozim kryesor të qenit çmimmarrës, pra mosndryshimin e çmimit në vendet partnere.

Nga studime të mëparshme është vërejtur se të ardhurat dhe çmimet relative janë të mjaftueshme për të modeluar lëvizjet e bilancit tregtar në vëllim. PBB, si përafresi më i mirë i të ardhurave kombëtare, është faktor përcaktues i kërkesës agregate për mallra dhe shërbime importi. Një rritje e nivelit të të ardhurave në vend, do të çojë në rritjen e kërkesës për importe, dhe pritjet që koeficienti i elasticitetit të importeve ndaj kërkesës agregate të jetë pozitiv dhe midis 0 dhe 1. Në kahun e eksporteve, rritja

e kërkesës agregate nga vendet që importojnë mallrat shqiptar duhet të nxisë rritjen e tyre.

Kursi real efektiv i këmbimit është një mënyrë për matjen e konkurrueshmërisë së një ekonomie. Normalisht, përdorimi i REER bazuar në pagat do të ishte më i përshtatshëm për këtë modelim, por një seri tre mujore të dhënash për pagat nuk është e disponueshme. Një ndryshim në REER rrjedh nga ndryshime në kurset nominale dypalëshe të këmbimit ose ndryshime në çmimet e mallrave në vend ose jashtë tij.

Kjo çon në ndryshimin e çmimeve relative të mallrave vendas dhe të importit, dhe si rrjedhim dhe në ndryshimin të kërkesës për to. Një zhvlerësim i REER përfaqëson zhvlerësim real të monedhës vendase, rritje të çmimeve reale të importeve, ndaj duhet të sjellë dhe rënie të vëllimit të importeve. Ndërkohë që për të njëjtat arsye, zhvlerësimi i REER duhet të japë efekt të kundërt tek vëllimi i eksporteve duke ndikuar në rritjen e tyre.

Duke u bazuar në teorinë ekonomike bilanci tregtar do të modelohet duke përdorur analizën e kointegrimit midis importeve (ekporteve), kërkesës agregate dhe kursit real të këmbimit duke shfrytëzuar modele të korrigjimit të gabimit (ECM). Modelet e korrigjimit të gabimit do të aplikohen si ndaj vëllimit të tregtisë ashtu edhe ndaj vlerës së bilancit tregtar.

Për zërat e tjerë të llogarisë korente, pra për shërbimet, të ardhurat dhe transfertat korente është parë i pamundur përdorimi i modeleve strukturore. Arsyeja për këtë është mungesa e variablave ekzogjenë që do të mund të përdoren për parashikimin e, për shembull, të ardhurave nga udhëtimet apo prurjeve nga emigrantët.

Konkretisht, për rastet e mësipërme do të duheshin të dhëna të sakta dhe të besueshme mbi numrin e udhëtarëve hyrës jorezidentë apo mbi numrin e emigrantëve afatgjatë që dërgojnë të ardhura në Shqipëri. Rrjedhimisht, në modelimin e këtyre llogarive jemi kufizuar në përdorimin e modeleve jostrukturore ARMA.

II – TRANSFERTAT KAPITALE

Transfertat kapitale nuk janë modeluar veçan pasi të dhëna mbi grantet për periudha afatgjata janë të disponueshme dhe lehtësisht të sigurueshme nga donatorët apo nga Ministria e Ekonomisë. Ato paraqiten në skedulet e disbursimit të granteve për vitet në vazhdim së bashku me projeksionet për marrëveshje të reja të mundshme.

III – LLOGARIA FINANCIARE

Zërat kryesorë të llogarisë financiare janë huamarrja shtetërore dhe investimet e huaja direkte (IHD). Të dhënat për huamarrjen shtetërore sigurohen nëpërmjet informacioneve zyrtare të Ministrisë së Financave, në bazë të marrëveshjeve që Qeveria e Shqipërisë ka lidhur me institucionet e ndryshme huadhënëse si FMN, BB etj.. Përsa i përket investimeve direkte , elemente përcaktuese të tyre duhet të jenë rritja e PBB-së dhe diferenca e normave të interesit midis vendit që shërben si burim kapitali dhe Shqipërisë. Parimisht, rritja e PBB-së së Shqipërisë do të shoqërohej me rritje të investimeve direkte dhe anasjelltas. Po ashtu, nëse Shqipëria do të ofronte norma reale interesi më të larta sesa vende të tjera, investitorë nga këto vende do të tërhiqeshin nga mundësia për të siguruar të ardhura më të mëdha nga investimet e tyre në Shqipëri. Megjithatë, duke pasur parasysh kufizimet lidhur me vlerësimin e këtij zëri, mendohet se një modelim me faktorë shpjegues makroekonomikë nuk do të japë rezultate të besueshme.

IV – MJETET E REZERVËS

Mjetet e rezervës së autoritetit monetar përfaqësojnë një të dhënë të besueshme dhe lehtësisht të matshme. Megjithatë, duke pasur parasysh përbërjen e saj është e vështirë të identifikosh elemente përcaktuese. Dy faktorë të rëndësishëm do të ishin diferenciali i normave të interesit dhe të inflacioneve me vendet që i përkasin monedhat si dhe ndërhyrjet në tregun valutor. Të dhënat për normat e interesit për depozitat në valutë për periudhat para vitit 2001 nuk janë të disponueshme, ndaj modelimi me variabla ekonomikë për

momentin nuk është i mundur. Ky modelim mund të kryhet në një periudhë të dytë, kur këto seri të jenë të disponueshme.

4. TË DHËNAT

Në këtë studim është punuar me të dhëna tremujore të kushtëzuara nga llogaritja e PBB-së. PBB është e disponueshme vetëm në nivel vjetor dhe nga ana statistikore ka kuptim vetëm ndarja e saj deri në frekuencë tremujore. Shpërndarja sipas tremujorëve është kryer duke përdorur sezonalitetin e ofertës së parasë (M3-it). Në përdorimin e PBB-së duhen pasur parasysh dhe pasaktësitë e lidhura me llogaritjen e këtij treguesi, ku nuk përfshihen transaksionet që i përkasin ekonomisë informale, mallrave të ndërmjetëm etj..

Si përfrues i kërkesës agregate për eksporte ishte menduar të përdorej mesatarja e ponderuar e PBB-ve⁴ të vendeve partnere në tregti dhe peshat do të përcaktoheshin nga peshat në vëllimin tregtar. Fatkeqësisht, seria e krijuar është shumë e shkurtër për t'u përdorur për vlerësime ekonometrike, sepse mënyra e llogaritjes së PBB-së së Greqisë ka ndryshuar në vitin 2001.

REER-i i përdorur është ai i përlllogaritur nga Vika (2004):

$$\text{REER} = \prod \left[\frac{C_h \cdot K_n}{C} \right]^{W_n}$$

Ku C_h përfaqëson indeksin e çmimeve të konsumit në vendet partnere, C indeksin e çmimeve të konsumit në vend, K_n është kursi nominal i këmbimit⁵ dhe W_n pesha e atribuar vendit partner, bazuar në peshën që ai zë në tregti. Sipas kësaj mënyre llogaritje rritja e REER nënkupton zhvlerësim të monedhës vendase dhe ulja e tij, vlerësim.

Të gjitha të dhënat janë të shprehura në milionë lekë dhe janë në formë fluksi⁶. Periudha e përdorur e të dhënave është 1996:T1 - 2003:T4, e kufizuar nga seria e indeksit të çmimeve të importit dhe eksportit. Vëllimi i importeve dhe i eksporteve llogaritet duke

bërë raportin e vlerave me indeksin përkatës të çmimeve njësi, të përgatitur nga INSTAT. Të gjitha seritë e marra në shqyrtim, përveç atyre të tregtisë në mallra, rezultuan stacionare. Për këtë arsye, bilanci tregtar është modeluar duke përdorur modelin e korigjimit të gabimit, ndërkohë që seritë e tjera të llogarisë korente dhe financiare janë modeluar duke përdorur modele ARMA.

Efekti i krizës së vitit 1997 shmanget nëpërmjet përdorimit të një variabli cilësor me vlerë 1 për tremujorët me efekt më të lartë të krizës së vitit 1997 dhe me vlerë 0 për të tjerët. Edhe efekti i luftës në Kosovë gjatë vitit 1999, i cili ka çuar në luhatje jonormale në bilancin e pagesave, shmanget nëpërmjet një variabli tjetër cilësor.

Një ndër problemet kryesore të hasura gjatë modelimit të zërave të bilancit të pagesave, ka të bëjë me vlerën vazhdimisht të lartë të zërit "gabime dhe harresa". Ky zë për vitin 2003 shënoi 36 për qind të bilancit korent, ndërkohë që në vitet paraardhëse ai ka arritur vlera akoma më të konsiderueshme. Fakti që të dhënat e analizuara kanë kufizimet e paraqitura në seksionin 4.1, çon dhe në besueshmëri jo të lartë të rezultateve të modelimit.

4.1. ZËRAT E LLOGARISË KORENTE, BURIMET E TË DHËNAVE DHE MANGËSITË NË STATISTIKA

1. Tregtia në mallra – Mallrat janë të lëvizshëm dhe të prekshëm nga pikëpamja fizike. Në mënyrë që një transaksion të regjistrohet si transaksion në "mallra", duhet që, midis palëve pjesëmarrëse në transaksion, të ndodhë një ndryshim pronësie. Në këtë rast, pronësia mbi mallin kalon nga një rezident i vendit që harton bilancin e pagesave tek një rezident i një vendi tjetër ose e kundërta. Mallrat e lëvizshëm përfshijnë mallrat e përgjithshëm, mallrat për përpunim të mëtejshëm, arin jomonetar etj.. Seritë e përdorura në këtë model janë në formën c.i.f. (importet) dhe f.o.b. (eksportet) dhe nuk janë të rregulluara për të marrë parasysh fenomenin e kontrabandës.

Burimi, forma dhe mangësitë e të dhënave: Statistikat e tregtisë në mallra, për faktin që sigurohen nga një burim i vetëm – Drejtoria e Përgjithshme e Doganave- vlerësohen si statistikat më të besueshme

të bilancit tonë të pagesave. Për hartimin e statistikave të tregtisë së jashtme, në Bankën e Shqipërisë, përdoren deklaratat doganore. Secila nga këto përmban të dhëna mbi llojin e mallit të tregtuar, vlerën në lekë etj.. Nga përpunimi i parë i të dhënave përftohen importet në vlerën c.i.f. (duke përfshirë koston e sigurimit dhe të transportit) dhe eksportet në vlerën f.o.b. (të zhveshura nga kostoja e sigurimit dhe e transportit). Mangësitë në statistikatat e tregtisë në mallra, lidhen me nënregjistrimin apo mosregjistrimin e mallrave që kalojnë kufijtë, pra me kontrabandën.

2. Shërbimet – Këto transaksione rezultojnë nga tregtimi i disa të mirave jo materiale, në formën e shërbimeve, midis rezidentëve të një ekonomie dhe jorezidentëve. Në këtë kategori bëjnë pjesë shërbime si: transporti, sigurimi, ndërtimi, turizmi, shërbimet financiare, dhënia e patentave etj.. Kur rezidentët paguajnë para për të blerë një shërbim nga jorezidentët, në llogarinë korente, shërbimi shënohet si import (debi) ndërsa përfitimi i parave në këmbim të shërbimeve të kryera për jorezidentët, shënohet si eksport (debi).

Burimi, forma dhe mangësitë e të dhënave: Statistikat e shërbimeve në bilancin tonë të pagesave hartohen në bazë të disa burimeve siç janë: bankat e nivelit të dytë, kompanitë e sigurimit, vrojtimet e turizmit, ministri të ndryshme etj.. Pavarësisht se burimet e përdorura janë më të shumta se për çdo kategori tjetër të bilancit të pagesave, një numër shërbimesh mbeten ende të pamatura mirë. Përdorimi i gjerë i cash-it në ekonominë shqiptare, e bën të pamundur kapjen e një pjese të madhe të transaksioneve, nëpërmjet të dhënave nga sistemi bankar.

Për shkak të mangësive dhe cilësisë jo të mirë të të dhënave në disa nënzëra të shërbimeve, në këtë studim janë shfrytëzuar për modelim vetëm importet dhe eksportet totale të shërbimeve.

3. Të ardhurat – Të ardhurat janë para që hyjnë apo që dalin nga vendi si rezultat i rrogave apo i interesave nga investimet e portofolit, investimet e rezervave, investimet direkte, prej dhënies apo marrjes borxh etj.. Në llogarinë tonë të të ardhurave, zëri me peshën më të madhe është “kompensimi i punonjësve” ose “të ardhura nga puna” (kredi) i vlerësuar si përqindje mbi totalin e remitançave.

Burimi, forma dhe mangësitë e të dhënave: Të dhënat mbi interesat nga rezervat, nga investimet e portofolit dhe të ardhurat nga borxhi janë relativisht të besueshme, pasi sigurohen nga sistemi bankar dhe organet qeveritare. Ndërkohë, të dhënat mbi të ardhurat nga kapitali (debi) janë të padisponueshme në pamundësi të sigurimit të informacionit nga sektori privat. Modelimi i kategorisë së të ardhurave do të kërkonte përdorimin e shumë variablove ekzogjenë për shpjegimin e disa variablove, që kanë regjistruar vlera relativisht të ulëta përgjatë viteve. Shlyerja e borxhit të jashtëm (debi), më tepër se sa nëpërmjet modelimeve ekonometrike, mund të parashikohet nëpërmjet skeduleve të përcaktuara të huamarrjes midis Qeverisë Shqiptare dhe huadhënësve. Ndërkohë, modelimi i të ardhurave (kredi) nga investimet e portofolit, investimet e rezervave apo të depozitave, do të kërkonte shfrytëzimin e një numri të madh të dhënash si normat e huaja të interesit etj.. Flukset e pakëta në këta zëra nuk justifikojnë një trajtim të tillë. Për këtë arsye në kategorinë e të ardhurave, për këtë studim, do të merren parasysh vetëm të ardhurat totale.

4. Transfertat korente – Transfertat korente janë transfertat të njëanshme, të cilat jepen ose merren pa marrë ose dhënë gjë tjetër në këmbim. Në këtë grup bëjnë pjesë: dërgesat e punëtorëve (remitancat), donacionet, ndihmat dhe grantet, asistencat teknike (falas) dhe pensionet. Për shkak të natyrës së tyre, transfertat korente nuk konsiderohen si burime reale që ndikojnë në prodhimin ekonomik.

Burimi, forma dhe mangësitë e të dhënave: Zëri me peshën më të madhe në transfertat korente është “dërgesat e punëtorëve” ose “prurjet nga emigrantët”. Ky zë llogaritet me një metodë vlerësimi, të bazuar mbi hyrje-daljet e valutës në tregun valutor. Për zërat e tjerë shfrytëzohen të dhëna nga sistemi bankar, nga Ministria e Ekonomisë, nga Drejtoria e Doganave etj.. Problemi më i madh në lidhje me këtë llogarim është fakti që për shkak të metodologjisë së përdorur, në zërin “prurje nga emigrantët” përfshihen edhe të ardhura në valutë, të gjeneruara nga aktivitete të tjera. Për këtë arsye, transfertat korente nuk mund të shpjegohen nëpërmjet faktorëve ekzogjenë.

4.2 ZËRAT E LLOGARISË KAPITALE DHE FINANCIARE, BURIMET E TË DHËNAVE DHE MANGËSITË NË STATISTIKA

Llogaria kapitale

Llogaria kapitale ndahet në falje borxhi dhe transfertat të tjera kapitale. Transfertat kapitale konsistojnë në investimet-ndihma, me qëllim shtesën ose financimin e formimit të kapitalit fiks në ekonominë e Shqipërisë.

Burimi, forma dhe mangësitë e të dhënave: Si burim për transfertat kapitale shërben informacioni i marrë nga Ministria e Financave dhe ajo e Ekonomisë. Të dhënat janë të sakta dhe gjithëpërfshirëse, por të vështira për t'u parashikuar dhe rrjedhimisht modeluar.

Llogaria financiare

Llogaria financiare paraqitet e ndarë në mjete dhe detyrime. Bilanci i llogarisë financiare për një periudhë, tregon diferencën midis rritjes (apo zvogëlimit) të mjeteve dhe rritjes (apo zvogëlimit) të detyrimeve. Një bilanc pozitiv në llogarinë financiare do të thotë që detyrimet e rezidentëve ndaj jorezidentëve janë rritur më shumë se pretendimet e rezidentëve ndaj jorezidentëve, ose që rritja e detyrimeve ndaj jorezidentëve ka ndodhur paralelisht me zvogëlimin e pretendimeve të rezidentëve ndaj jorezidentëve.

1. Investimet e huaja direkte – Investim i huaj direkt është pjesëmarrja, me më shumë se 10 për qind të kapitalit ose të vendimmarrjes, e një investitori të huaj në një ndërmarrje në vendin hartues të statistikës. Investimi direkt ndahet në kapital aksioner, të ardhura të riinvestuara dhe kapital tjetër.

Burimi, forma dhe mangësitë e të dhënave: Të dhënat për investimet direkte sigurohen nga një numër kompanish të huaja të mëdha çdo tremujor si edhe duke shfrytëzuar informacion për të ardhurat nga privatizimi. Statistika zyrtare, për shkak të vështirësive në mbulimin e burimeve, duhet të nënvlerësojë ndjeshëm shifrat reale. Për investimet direkte dalëse nuk ka asnjë burim të dhënash.

2. Investimet e portofolit – Këto investime përfshijnë letra me vlerë afatgjata të borxhit dhe të pjesëmarrjes, instrumente të tregut të parasë dhe derivativa financiarë të tregtueshëm.

Burimi, forma dhe mangësitë e të dhënave: Burimi i të dhënave për investimet e rezidentëve jashtë është sistemi bankar. Investimet e bankave, të kompanive apo të individëve në instrumente të tilla lejohet të kryhen vetëm nëpërmjet bankave tregtare.

3. Investime të tjera- Në këtë grup përfshihen huamarrja private dhe shtetërore, depozitat e vendosura nga jorezidentët me rezidentët (detyrime) dhe anasjelltas (mjete), kredi tregtare etj..

Burimi, forma dhe mangësitë e të dhënave: Si burim kryesor për këtë grup-zërash shërben sistemi bankar dhe burime të tjera institucionale si Ministria e Financave apo huadhënës të ndryshëm privatë. Kryesisht e pambuluar mbetet huamarrja private, kreditë tregtare dhe monedha e huaj në pronësi të rezidentëve.

4.3 MJETET E REZERVËS

Mjetet e rezervës konsistojnë në ato mjete të jashtme që janë menjëherë të përdorshme dhe kontrollohen nga autoritetet monetare për financimin direkt të çbalancimeve (deficiteve) në pagesa, për rregullimin indirekt të madhësisë së këtyre çbalancimeve nëpërmjet ndërhyrjeve në tregjet valutore, duke ndikuar mbi kursin e këmbimit të monedhës dhe/ose për qëllime të tjera. Si burim për këtë statistikë shërben Banka e Shqipërisë.

5. REZULTATET

I – LLOGARIA KORENTE

Modelimi i bilancit tregtar sipas vëllimit

Analiza e ecurisë së vëllimeve të import/eksporteve, kur është e mundur, preferohet ndaj analizës së ecurisë së vlerave. Seritë e

shprehura në vëllim, duke qenë të zhveshura nga efekti i kursit të këmbimit japin një ide më të qartë mbi ecurinë e tregtisë si edhe mundësojnë zbulimin e lidhjeve më të besueshme midis vëllimit dhe faktorëve ekzogjenë. Një analizë e tillë është e mundur në kushtet tona, duke qenë se seri të indekseve të vlerës njësi për importet dhe eksportet janë llogaritur nga INSTAT që prej vitit 1996. Theksojmë se këto seri nuk përfaqësojnë indekse të mirëfillta çmimesh, por sigurojnë një proxy të pranueshëm për deflatimin e serive në vlera. Duke qenë se seritë në vëllim janë të disponueshme vetëm për bilancin tregtar, për pjesën e parashikimit janë përdorur seritë në vlera. Modelimi i bilancit tregtar në vlera, vlerësohet si i rëndësishëm për parashikimin e vetëm këtij treguesi për periudha afatshkurtra, si edhe në rastet kur disponohen të dhëna për zhvillimet e ardhshme në çmimet ndërkombëtare.

Pas aplikimit të procedurës Johanssen⁷ vërehet se ekziston vetëm një vektor kointegrimi, domethënë një lidhje afatgjatë, midis vëllimit të importeve, kërkesës agregate (PBB) dhe REER-it.

Tabelë 1. Modeli i korigjimit të gabimit për vëllimin tremujor të importeve.

Variabli i varur: DLOG(IMPVOL)				
Periudha(e axhustuar): 1997:2 2003:4				
